

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-116/2014
GSK-KPA-A-117/2014**

Prishtinë, 20 Prill 2016

Në çështjen juridike të:
Subjekti juridik **U. K.DOO**

Pala ankuese

Përfaqësues: A. Q. V.
Avokat në Prishtinë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) nr. KPCC/D/A/212/2013 i datës 21 gusht 2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) me numrat KPA13390 dhe KPA13389), në tekstin e mëtejme gjithashtu: Vendimi i KKPK-së, pas shqyrtimit të mbajtur më 20 Prill 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM:

Hidhen poshtë si të pasafatshme ankesat e U. K. DOO kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/212/2013, i datës 21 gusht 2013, për sa i përket kërkesave me numrat KPA13390 dhe KPA13389.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 7 shtator 2006 M. R. si përfaqësues i autorizuar i subjektit juridik U. .c DOO (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon vërtetimin e të drejtës së tij pronësore, ri-posedimin dhe kompensimin për shfrytëzim të jashtëligjshëm
 - a) sipas njërës kërkesë, të tokës afariste pa objekte që ndodhet në Livade, Prishtinë, ngastra kadastrale nr. 1559/11, Komuna e Prishtinës, në sipërfaqe prej 00.79.70 ha;
 - b) sipas kërkesës tjetër, të një ngastre toke të pakultivueshme në zonën industriale në Prishtinë, në sipërfaqe prej 10.00.00 ha;(bashkërisht në tekstin e mëtejme: pronat e kërkuara).
2. Kërkesa e paraqitur në paragrafin 1.a ishte regjistruar në AKP me numrin KPA13390 dhe kërkesa nën 1.b me numër KPA13389.
3. Njoftimi i kërkesës nr. KPA13390 është bërë më 7 gusht 2008, dhe është vendosur shenja në ngastrën e kërkuar. Gjatë njoftimit, AKP-ja ka gjetur se prona është kullosë dhe nuk është e uzurpuar.
4. Njoftimi i kërkesës nr. KPA13389 është bërë përmes publikimit në Gazetën e Njoftimeve të AKP-së nr.11 dhe në Buletinin e Zyrës për Pronë të UNHCR-t, më 25 prill 2013, pasi AKP-ja nuk ka mundur të sigurojë asnjë dokument rreth pronës nga zyra kadastrale komunale.
5. Asnjë palë e interesuar nuk i është qasur AKP-së, prandaj kërkesat janë konsideruar si të pakontestueshme.
6. KKPK-ja me vendimin KPCC/D/A/212/2013, të datës 21 gusht 2013, ka refuzuar kërkesat me arsyetimin (në paragrafët 12 dhe 99-101, 116) se pala ankuese nuk ka ofruar ndonjë provë për të dëshmuar të drejtën e tij pronësore apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore ndaj pronës së kërkuar. Kërkesat për kompensim janë refuzuar pasi që KKPK-

ja nuk ka juridiksion ndaj kërkesave të tilla. Në fletën e fundit vendimi i KKPK-së përmban informata lidhur me mundësinë për të paraqitur një ankesë brenda 30 ditësh nga njoftimi me vendimit.

7. Vendimi për të dyja kërkesat, së bashku me një fletë informuese mbi ankesat, i janë dorëzuar ndaras përfaqësuesit të autorizuar të palës ankuese, M. R., më 10 shkurt 2014.
8. Më 26 mars 2014, pala ankuese ka paraqitur ankesat kundër vendimeve për të dyja kërkesat.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese e kundërshton vendimin e KKPK-së për të dyja kërkesat duke pretenduar që përmban gabim thelbësor dhe shkelje serioze të së drejtës procedurale dhe është i bazuar në vërtetimin jo të plotë të fakteve. Prandaj, ka kërkuar nga Gjykata Supreme ta pranojë ankesën e tij dhe ta anulojë vendimin e KKPK-së si të pabazuar dhe të jashtëligjshëm.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

10. Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50) parashihet si në vijim: “Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”.
11. Vendimi i KKPK-së për të dyja kërkesat i është dorëzuar palës ankuese më 10 shkurt 2014 dhe pala ankuese duhej të dorëzonte ankesat brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet nga dispozita e lartpërmendur. Pala ankuese ka paraqitur ankesë vetëm të mërkurën më 26 mars 2014. Kjo datë është dita e 44-të pas njoftimit me vendimin e KKPK-së dhe është pas afatit siç parashihet me ligj.

12. Pala ankuese nuk ka dhënë asnjë arsyetim rreth paraqitjes së ankesave pas afatit të caktuar.
13. Ai ishte njoftuar mjaftueshëm rreth afatit, pasi që edhe vendimi përmbante një paralajmërim rreth këtij afati.
14. Prandaj, ankesat duhet të hidhen poshtë si të pasafatshme në pajtim me nenin 13.3 nën-paragrafi (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe nenin 195.1 (a) të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Këshillë juridike

15. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Nënshkruar nga: Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it